



Prishtinë, 30 mars 2018

Komunikatë për media

Bordi ZRRE ka mbajtur takimin e tij të parë (I) për vitin 2018

Dje me 29 mars 2018, pas funksionalizimit të tij me emërimin edhe të dy anëtarëve të rinj nga Kuvendi i Kosovës, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka mbajtur mbledhjen e tij të parë për këtë vit. Ndër të tjera, në këtë mbledhje janë shqyrtuar njëzetedy (22) kërkesa për ndërtim të kapaciteteve të reja të bazuara në burimet e ripërtrithshme të energjisë. Me këtë rast, janë lëshuar autorizimet finale për ndërtim të dy hidrocentraleve me një kapacitet instalues prej 8.3 MW, të cilat do të ndërtohen në Komunën e Dragashit dhe atë të Hanit të Elezit. Dy projekteve me panele Solare/Fotovoltaike që përbëjnë një kapacitet prej 6 MW dhe dy nga Era me kapacitet të përbashkët prej 64.8 MW u janë lëshuar Autorizimet Preliminare ndërsa 7 projekteve të cilat janë të pajisura me Autorizime Finale ju është vazhduar afati i autorizimit për përfundimin e ndërtimit, dhe 7 projekteve të tjera u është shtyrë afati i vlefshmërisë së Autorizimit Preliminar, me qëllim të përmbushjes së kushteve për lëshimin e Autorizimit Final për ndërtim.



Takimi i parë i Bordit të ZRRE - 29 mars 2018

Në këtë mbledhje po ashtu është paraqitur Raporti Vjetor i punës së ZRRE për vitin 2017, i cili do të dërgohet në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim, si dhe janë shqyrtuar 20 apeline të vendimeve të ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike.

Pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit KEK sh.a., për vazhdimin e licencës për prodhim të energjisë elektrike nga termocentrali "Kosova A" dhe analizimit të situatës me furnizim me energji elektrike në vend, Bordi ka vendosur që ti vazhdohet licenca edhe për një vit.

Bordi ka shqyrtuar edhe disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me rregullimin e sektorit si dhe menaxhimin e Zyrës së Rregullatorit.